




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



Njësia e Auditimit të Brendshëm / Jedinica Unutrašnje Revizije / Internal Audit Unit



PLANI VJETOR

I Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjilanit për vitin
2023

27.12.2022
GJILAN

Për: Z. Alban Hyseni – Kryetar i Komunës së Gjilanit

Z. Nexhmedin Bislimi – Kryesues i Komitetit të Auditimit

Nga: Sherafedin Latifi – Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Më 27.12.2022

Lënda: Letër Njoftuese për Planin Vjetor të punës së NJAB-së për vitin 2023

Kamë kënaqësinë, që në mbështetje të nenit 25 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr.06/L-021, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Udhëzimet Administrative, Instruksionet financiare në fuqi, Udhëzimi Evropian mbi Kontrollin-INTOSAI-T, Doracakët e Auditimit të Brendshëm, Statutin e NJAB-së, si dhe nevojën e menaxhmenteve komunale për kryerjen e auditimeve të brendshme në Komunë, do të ju prezantoj Planin Vjetor të NJAB-së për vitin 2023 të bazuar kryesisht në Planin Strategjik të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2023 – 2025.

Edhe këtë vit ne kemi kërkuar bashkëpunim nga menaxhmenti i lartë dhe menaxhmentet e Drejtorive Komunale për identifikimin e objektivave me prioritet për auditim, si dhe identifikimin e faktorëve të rrezikut të cilët janë pengesë eventuale për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të Drejtorive. Kërkesat, sugjerimet apo nevojat e tyre i kemi përfshirë në përmbajtjen e këtij Plani Vjetor bashkë me njohuritë nga të gjeturat e auditimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe njohurive nga auditimet e NJAB-së të kryera më herët, ku i kemi identifikuar fushat e reja kyçe në të cilat do të përqendrohemi gjatë auditimit dhe do të punojmë me tërë forcën për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve tona.

Bashkangjitur kësaj letre keni Planin Vjetor të punës për vitin 2023, në të cilin janë identifikuar auditimet që do të ndërmerren, atributet të cilat duhet të rishikohen, janë përcaktuar prioritetet dhe koha e nevojshme për zbatimin e këtij programi.

Z. Kryetar i Komunës dhe Kryesues i Komitetit të Auditimit ju lutem që ta shqyrtoni dhe apromoni këtë Plan Vjetor të NJAB-së për vitin 2023.

PËRMBAJTJA:

Letra njoftuese për Planin Vjetor të punës për vitin 2023	2
I. HYRJE	4
II. AKTIVITETET E NJËSISË SË AUDITIMI TË BRENDSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE.....	4
III. DETYRAT E AUDITIMIT.....	5
3.1. Detyrat e pa zbatuara nga viti i kaluar.....	5
3.2. Auditimet e njësive/sistemeve strukturore që janë duke u zhvilluar.....	5
3.3. Llojet e detyrave të auditimit.....	5
IV. RADHITJA E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA TË AUDITIMIT ME STRATEGJINË E AUDITIMIT.....	6
V. PROKURIMI I BURIMEVE DHE NDARJA E DETYRAVE TË AUDITIMIT.....	9
5.1 Koha efektive e punës.....	10
VI. APROVIMI I PLANIT VJETOR.....	10

I. HYRJE

Ky planë vjetor është përpiluar në bazë të aktiviteteve të auditimit të brendshëm të përcaktuara për periudhën 2023-2025 e të paraqitura në Planin Strategjik të NJAB-së.

Plani Vjetor i NJAB-së për vitin 2023 përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjilanit përbëhet prej Drejtorit të NJAB-së dhe tre auditorëve.

Mirëpo sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.02-775 datë 05.10.2016 nga 05.10.2016 njërit auditor i është pezulluar pozita e auditorit deri me një kohë të pa caktuar për shkak të një Aktakuze të ngritur ndaj tij për periudhën kur ai nuk ka qenë auditor. Sipas konsultimeve me Njësine Qendrore për Harmonizimin e auditimit të Brendshëm, ndarja e detyrave të punës për Planin Vjetor të vitit 2023 është bërë për Drejtorin e NJAB-së dhe dy auditor. Varësisht prej rrjedhës së këtij Aktgjykimi dhe vendimit përmbyllës të Gjykatës, do të bëhet edhe korigjimi i Planit Strategjik dhe atij Vjetor.

Pra Plani vjetor duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që të mund të pasqyrojë ndryshimet me rendësi që ndodhin në organizatë apo në Njësine e Auditimit të Brendshëm, si dhe nga detyrat shtesë që propozohen nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i planit vjetor do të aprovohet nga Kryetari i Komunës.

II. AKTIVITETET E NJËSISË SË AUDITIMI TË BRENDSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Në vitin 2023 Njësia e Auditimit të Brendshëm planifikon realizimin e detyrave dhe aktiviteteve në vijim për arritjen e objektivave të theksuara në planin strategjik.

Nr	Objekti strategjik	Aktivitetet për arritjen e objektivit	Detyrat
1	Përmirësimin e kontrollit të brendshëm të organizatës duke ofruar vlerësim objektiv dhe rekomandimet për përmirësim	Rishikimi i vlerësimit objektiv për përmasimin e kontrollit brendshëm	Shërbime sigurie
2	Përmirësimin e të kuptuarit të funksionit të kontrollit të brendshëm	Rishikimi për të vlerësuar të kuptuarit e funksionit të mjedisit kontrollit brendshëm nga menaxhmenti.	Shërbime sigurie
3	Të ndihmohet organizata që të formoj procesin për menaxhimin e rrezikut	Rishikimi i vlerësimit që të formojë proceset për menaxhimin e rrezikut.	Shërbime sigurie
4	Ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e rrezikut në organizatë	Rishikimi i vlerësimit për ngritjen e vetëdijes në menaxhimin e rrezikut në organizatën buxhetore.	Shërbime sigurie
5	Asistencë për zhvillimin e monitorimit në organizatë	Rishikimi i vlerësimit për asistencë në zhvillimin e monitorimit në organizatën buxhetore.	Shërbime sigurie
6	Zhvillimi dhe avansimi i vazhdueshëm i stafit të NJAB-së;	Rishikimi i vlerësimit të nevojave për trajnime profesionale – avansuese për stafin e NJAB-së.	Shërbime sigurie

III. DETYRAT E AUDITIMIT

3.1. Detyrat e pa zbatuara nga viti i kaluar

Nga plani i vitit 2022 nuk është arritur të kryhet auditimi në NPL "Tregu", me që me kërkesë të Kryetarit të Komunës është kryer një auditim në Drejtorinë e Inspeksionit, gjegjësisht vetëm në Inspeksionin e Ndërtimit. Gjithashtu do të vazhdohet me procesin e verifikimit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm dhe Auditorit të Përgjithshëm, ashtu që të gjeturat nga ky verifikim të paraqiten në Raportin Vjetor të NJAB-së deri me 15.01.2023.

3.2. Auditimet e njësive/sistemeve strukturore që janë duke u zhvilluar

Në pjesën e mbetur të vitit 2022 sipas planit vjetor të paraparë parashihet të kryhet Verifikimi i implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2022.

3.3. Llojet e detyrave të auditimit

Indeksi rrezikut	Lloji i detyrës	Njësia strukturore	Objekti i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Periudha Viti 2023
2.224	DSHS 2323	Ndërmarrja Publike Lokale "Tregu"	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore gjatë procesit të të Hyrave, Shpenzimeve dhe funksionimit të NPL „Tregu” SH.A-Gjilan.	01.01.2021 31.01.2023	Janar - Shkurt
2.994	DSHS 2313	Drejtorja për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim (DSHPIB)	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore gjatë procesit të të Hyrave dhe Shpenzimeve në DSHPIB	01.01.2021 28.02.2023	Janar - Shkurt
1.672	DSHS 2318	Drejtorja për Kulturë R.S Drejtorja e Bujqësisë Drejtorja e SHMS-së	Auditim i performancës: Shpenzimet e Subvencioneve	01.01.2022 01.01.2023	Mars- Prill
2.559	DSHS 2303	Organizata Buxhetore e Administratës Komunale	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore dhe procedurave të procesit të shpenzimeve.	01.03.2022 28.02.2023	Maj Qershor
2.654	DSHS 2301	Zyra e Prokurimit	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore të procedurave të prokurimit publik	01.07.2022 31.07.2023	Korrik - Gusht
2.415	DSHS 2304	Drejtorja për Buxhet dhe Financa – Të hyrat nga Tatimi në Pronë	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore të procedurave të grumbullimit të të Hyrave nga Tatimi në Pronë.	01.08.2022 30.09.2023	Shtator-Tetor
2.284	DSHS 2305	Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore gjatë procesit të të Hyrave në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	01.12.2021 31.09.2023	Shtator-Tetor
2.624	DSHS 2302	Organizata Buxhetore – Administrata Komunale	Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore lidhur me menaxhimin e pasurisë komunale	01.12.2022 30.11.2023	Nëntor- Dhjetor
	DSHS 2322	Organizata Buxhetore – Komuna	Verifikimi i implementimit të rekomandimeve të AB dhe AP	01.01.2022 31.12.2023	Nëntor- Dhjetor
		Organizata Buxhetore – Komuna	Me kërkesë të menaxhmentit	01.01.2023 31.12.2023	Janar -Dhjetor

IV. Radhitja e detyrave të planifikuara të auditimit me strategjinë e auditimit

Detyrat e auditimit të planifikuara në planin strategjik dhe planin vjetor për Njësinë e Auditimit të Brendshëm janë si vijon:

Nr.	Njësia e synuar e auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	E planifikuar për vitin 2023	Nr. i detyrës së auditimit
1	Zyra e Prokurimit	2.654	Lartë	X	DSHS 2301
2	Menaxhimi i pasurisë në tërë Organizatën Buxhetore – Komunën	2.624	Lartë	X	DSHS 2302
3	Procesi i Shpenzimeve në Administratën Komunale	2.559	Lartë	X	DSHS 2303
4	Performanca e të hyrave në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa - Sektori i Tatimit në Pronë	2.415	Lartë	X	DSHS 2304
5	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit:	2.284	Mesëm	X	DSHS 2305
6	Njësia Buxhetore e Shëndetësisë – Procesi i Shpenzimeve	2.254	Mesëm		DSHS 2306
7	Të hyrat në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme	2.250	Mesëm		DSHS 2307
8	Drejtoria e Inspeksionit	2.231	Mesëm		DSHS 2308
9	Njësia Buxhetore e Arsimit – Procesi i Shpenzimeve dhe i të Hyrave vetanake	2.139	Mesëm		DSHS 2309
10	Të Hyrat në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	2.186	Mesëm		DSHS 2310
11	Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport	2.077	Mesëm		DSHS 2312
12	Të Hyrat nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale	2.048	Mesëm		DSHS 2311
13	Të hyrat dhe shpenzimet në Drejtorinë për Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim	1.994	Mesëm	X	DSHS 2313
14	Organizata Buxhetore e Administratës Komunale - Menaxhimi i resurseve humane dhe - Sistemi i Pagave dhe mëditjeve.	1.788	Mesëm		DSHS 2314
15	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari	1.772	Mesëm		DSHS 2315
16	Të hyrat vetanake në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoritë të tjera	1.681	Ulët		DSHS 2316
17	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	1.623	Ulët		DSHS 2317
18	Shpenzimet e Subvencioneve	1.672	Ulët	X	DSHS 2318
19	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim – Brigada e Zjarrfikësve - Shpenzimet	1.610	Ulët		DSHS 2319
20	Menaxhimi i automjeteve komunale	1.640	Ulët		DSHS 2320
21	Të Hyrat në Drejtorinë Komunale të Arsimit	1.594	Ulët		DSHS 2321
22	Ndërmarrja Publike Lokale “Tregu”	2.224	Mesëm	X	DSHS2323
23	Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm		Lartë	X	DSHS 2322
24	Auditimi me kërkesë të menaxhmentit		Lartë	X	

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2023 përputhen me strategjinë e aprovuar të auditimit për 76.92%.

Mospërputhja e plotë ka ndodhur për shkak të kalkulimit të kohës efektive të punës për Drejtorin e NJAB-së dhe dy auditor, e jo për tre auditor si në Planin Strategjik (*shpjegimi i arsyes është dhënë më lartë*).

Edhe për vitin 2023 kemi vazhduar me planifikimin sipas pritjeve të rezultateve nga puna dhe angazhimet e auditorëve si në vitin e kaluar, ashtu që kemi bërë kalkulimin e Kohës Efektive të Punës (KEP) veq e veq për secilin auditor, duke qenë në pritje të angazhimeve të tyre në mënyrë më profesionale, më cilesore dhe më efikase në menaxhimin e kohës gjatë kryerjes së auditimeve. Për vitin 2023 kemi kalkuluar kohën efektive të punës në atë mënyrë që jo në të gjitha auditimet të punohet paralelisht në dy auditime, por do të ketë auditime ku dy auditor do të jenë të angazhuar njëkohësisht në një auditim. Kjo nënkupton kufizimin e planifikimit të numrit të auditimeve në krahasim me numrin e auditorëve dhe ditëve efektive për punë.

Gjithashtu në këtë Plan për vitin 2023 me sugjerim dhe mbështetje të ekspertëve nga Projekti i USAID-it: Integriteti i Komunave të Kosovës dhe të Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm kemi planifikuar një auditim të Përfundimit me temë për subvencionet e dhëna kryesisht nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari dhe nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Andaj të vetëdijshëm për kohën e nevojshme më të gjatë për një auditim të performancës në tabelën e sipërme kemi kalkuluar një kohë më të gjatë, duke llogaritur edhe në angazhimin e tre auditorëve njëkohësisht, me që ky auditim do të kryhet kryesisht në mbikëqyrjen e këshilltares për auditim në kuadër të projektit të lartcekur.

Edhe për vitin 2023 sipas këtij Plani Vjetor kemi bërë përpjekje për koordinimin e punëve për kryerjen sa më të mirë të detyrave të ndara, gjithnjë duke i pasur parasysh parimet bazike të auditorit të brendshëm, si dhe shkallën e rrezikshmërisë së auditimeve.

Caktimi i auditorëve për kryerjen e auditimeve të planifikuara është bërë sipas vlerësimit të përgatitjes profesionale të auditorëve, përballë detyrave që duhet audituar.

Që të dy ekipet audituese do të jenë në vazhdimësi të mbikëqyrur dhe të ndihmuar nga Drejtori i NJAB-së, ashtu që ditët e planifikuara për mbikëqyrje dhe ndihma janë kalkuluar në totalin e ditëve të parapara për një auditim.

Edhe në këtë vit gjithnjë mbetet si opsion shfrytëzimi i ditëve të lira (eventuale) nga ato të paraparat me planë për auditime të radhës të dalura sipas koeficientit të rrezikshmërisë në Planin Strategjik, apo për auditime me kërkesë të menaxhmentit të lartë të Komunës.

Gjatë përpilimit të këtij Plani Vjetor, vështirësi të theksuara kanë paraqitur pasojat e periudhës pandemike Covid 19, ku gjatë rishikimit të Planit Vjetor për vitin 2021 dhe 2022 është dashur të anulohen disa auditime, e të cilat auditime tani janë bartur për Planin Vjetor të vitit 2022 dhe 2023, e që njëkohësisht është çrregulluar orari i auditimeve të parapara me Planin Strategjik për vitet 2022-2024, por edhe për vitet 2023-2025. Pra për të përgatitur një Planë të auditimeve sa më të nevojshëm, është dashur të bëjmë një rivlerësim të rreziqeve të objektivave që janë caktuar për auditim dhe sipas koeficienteve të rreziqeve të dala është krijuar Lista e auditimeve më me prioritet duke u ranguar sipas niveleve të rreziqeve (i lartë, i mesëm dhe i ulët).

Gjithashtu bazuar në planin Strategjik 2023-2025 për vitin 2023 është kërkuar së paku angazhimi edhe i një auditori (sipas kriterëve ligjorë të parapara), kryesisht për shkak të moshës para pensionimit të dy auditorëve.

Raporti në mes të detyrave të planifikuara në Planin strategjik dhe në planin vjetor tregohet në tabelë në vijim:

Llojet e detyrave të auditimit	Numri i detyrave për vit	Nr. i përgjithshëm i ditëve për person	Detyrat e auditimit sipas Planit Strategjik	Zbatimi i planit i shprehur në përqindje
Detyrat për shërbimet e sigurisë				
Rrezik i lartë	4	140	4	100 %
Rrezik i mesëm	3	105	6	50.00 %
Rrezik i ulët	1	50	3	33.33%
Përcjellja e rekomandimeve	1	50	1	100 %
Auditimet me kërkesë të menaxhmentit	1 Një auditor	30	1	100 %
Detyrat për shërbimet këshilluese dhe punë tjera të auditimit	Drejtori i NJAB-së dhe dy auditor	139	206	67.48 %
Plani Strategjik dhe Vjetor	Drejtori i NJAB-së	25	25	100 %
Koha për trajnime	3 auditor	60	60	100%
Detyrat e auditimit që janë duke u zhvilluar	1	8	8	100%
Hetimet e mashtrimit	1	5	18	28.8%
Gjithsejt:	10	612	817	74.91%

V. PROKURIMI I BURIMEVE DHE NDARJA E DETYRAVE TË AUDITIMIT

5.1 Koha efektive e punës

Koha efektive e punës kalkulohet për Drejtorin e NJAB-së dhe dy auditorët që ka Njësia e Auditimit të Brendshëm në pajtueshmëri me strategjinë e auditimit si vijon:

Gjashtë mujori GJM		Detyrat e auditimit	Prioriteti i njësive të synuar të auditimit	Ditë për një ekip	Mbikëqyrësi i ekipit	Anëtarët e ekipit	
						Ekipi 1	Ekipi 2
GJM-I-rë	1	DSHS 2323	Rrezik i mesëm	35	Sherafedin Latifi	Kamer Bajrami	
	2	DSHS 2313	Rrezik i mesëm	35	Sherafedin Latifi		Ajninur Sherifi
	3	DSHS 2318	Rrezik i ulët	50	Sherafedin Latifi	Kamer Bajrami Ajninur Sherifi	
	4	DSHS 2303	Rrezik i lartë	35	Sherafedin Latifi		Ajninur Sherifi
GJM-II-të	5	DSHS 2301	Rrezik i lartë	35	Sherafedin Latifi	Kamer Bajrami	
	6	DSHS 2304	Rrezik i lartë	35	Sherafedin Latifi		Ajninur Sherifi
	7	DSHS 2305	Rrezik i mesëm	35	Sherafedin Latifi		Kamer Bajrami Ajninur Sherifi
	8	DSHS 2302	Rrezik i lartë	35	Sherafedin Latifi	Kamer Bajrami Ajninur Sherifi	
	9	DSHS 2322	Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandim.	50	Sherafedin Latifi		Ajninur Sherifi Kamer Bajrami
	10	Me kërkesë të menaxhmentit		30	Sherafedin Latifi	Kamer Bajrami	Ajninur Sherifi
Numri i përgjithshëm i ditëve për aktivitetet e auditimit për Njësine e Auditimit të Brendshëm (295 + 50 +30)				375	Sherafedin Latifi	Ajninur Sherifi	Kamer Bajrami
Planifikimi strategjik dhe vjetor				25	Sherafedin Latifi		
Aktivitete Administrative				139	Sherafedin Latifi	Ajninur Sherifi	Kamer Bajrami
Numri i përgjithshëm i ditëve për trajnime				60	Sherafedin Latifi	Ajninur Sherifi	Kamer Bajrami
Ditët për detyrat e auditimit që janë duke u zhvilluar				8	Sherafedin Latifi	Ajninur Sherifi	Kamer Bajrami
Hetimet e mashtrimit				5	Sherafedin Latifi	Kamer Bajrami	Ajninur Sherifi
Gjithsej Koha Efektive e Punës (375 + 25 +139 +60+ 8+5)				612			

PËRCAKTIMI I KOHËS EFEKTIVE TË PUNËS PËR PLANIN VJETOR 2023
(për tre auditor)

Auditorët	Gjithsej ditë	Pushimi vjetor apo mungesa	Pushimi mjekësor	Koha efektive e punës (KEP)	Zbatimi i detyrave të auditit	Trajnimi dhe kualifikimi	Aktivitetet administrative	Planifikimi strategjik dhe vjetor
	1	2	3	4	5	6	7	8
Drejtori i NJAB	249	26	20	203	107	20	51	25
Auditori 1	249	25	20	204	140	20	44	
Auditori 2	249	24	20	205	141	20	44	
GJITHSEJ	747	75	60	612	388	60	139	25

Sqarim:

Në ditët e ndara për aktivitete administrative, për shërbime këshilluese dhe punë tjera të auditimit, në mes të tjerash janë përfshirë edhe ditët e planifikuara për takime me Komitetin për Auditim të Brendshëm, takime me Kryetarin e Komunës, takime me Këshillin e Drejtorëve, monitorimin e disa Seancave të Kuvendit Komunal, bashkpunimi me Auditorin e Përgjithshëm si dhe ditët për përgatitjen e Raporteve gjashtëmujore, vjetore si dhe informatave të tjera sipas nevojës.

Nga koha e përgjithshme efektive e punës prej 612 ditëve (3 auditor x 204 ditë = 612) për vitin 2023 ne kemi planifikuar kohën prej 14.706% nga koha e vetëm një auditori i cili eventualisht do ta kryej atë auditim sipas kërkesës së menaxhmentit (koha e një auditori 204 x 14.706 % = 30 ditë). Nga kjo përqindje rezulton se për auditime sipas kërkesës së menaxhmentit të lartë Njësia e Auditimit të Brendshëm ka planifikuar 30 ditë. Varësisht prej planit operativ, auditimet do të bëhen vetëm nga njëri auditor apo nga dy auditor bashkë.

VI. APROVIMI I PLANIT VJETOR

Për të qenë në funksion të Njesisë së Auditimit të Brendshëm ky plan duhet të aprovohet nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit. Pas aprovimit të këtij plani nga kompetentët e lartë cekur, Njësia e Auditimit të Brendshëm në vitin 2023 do të fillon punën për realizimin e këtij plani, gjithnjë në bazueshmëri të legjislacionit aktual të aplikueshëm për auditim të brendshëm.

Data: 27.12.2022

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm
Sherafedin Latifi

Ky Plan Vjetor i NJAB-së për vitin 2023 aprovohet nga:

Nexhmedin Bislimi

NBislimi

/Kryesues i Komitetit të Auditimit/

Alban Hyseni

Alban Hyseni

/Kryetar i Komunës së Gjilanit/

